

SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

***“Ujesjelles Kanalizime” sha Roskovec
(Per ushtrimin e mbyllur ne date 31 Dhjetor 2020)***

Ujesjelles Kanalizime sha Roskovec

SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

(të Ushtrimit të mbyllur më datë 31.12.2020)

25 Mars 2021

Informacion i përgjithshëm

SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

“Ujesjelles Kanalizime” sha Roskovec (Per ushtrimin e mbyllur ne date 31 Dhjetor 2020)

“Ujesjelles Kanalizime” sha Roskovec është Shoqëri aksionere, themeluar me dt. 26.09.2016 me aksionere te vetme Bashkine Roskovec, rregjistruar ne Drejtorine Rajonale Tatimore Fier me NIPT L63327402A.

Veprimtaria e shoqerise rregullohet sipas dispozitave te Ligjit Nr.9901 dt.14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare” i ndryshuar, nga statuti i saj dhe Legjislacioni ne fuqi.

Selia e shoqërisë është në Rruga nacionale Fier-Berat, rruga Syri Balla, Roskovec.

Objekti i veprimtarise se Shoqerise “Ujesjelles Kanalizime” sha Roskovec eshte: “Furnizimi me uje pishem dhe largimi i ujrave te ndotura ”.

Shoqeria “Ujesjelles Kanalizime” sha Roskovec ***administrohet*** nga administratori i shoqërisë z. Isa Hoxha, i cili ka kompetenca për drejtimin e saj mbi bazën e statutit.

Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin Nr. 25/2018, date 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Leke, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël. Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

“Ujesjelles Kanalizime” sha Roskovec (Per ushtrimin e mbyllur ne date 31 Dhjetor 2020)

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50%, në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

Krahasueshmëria e informacionit kontabël

Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitet të përmirësuar nr.1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare, informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përvec rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

Transaksionet në monedhë të huaj.

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2020	2019
------------------	------	------

SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

“Ujesjelles Kanalizime” sha Roskovec (Per ushtrimin e mbyllur ne date 31 Dhjetor 2020)

Euro/LEK	123.7	121.77
USD/LEK	100.84	108.64

Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme. Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë. Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

- Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

- Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

- Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

- Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si

SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

“Ujesjelles Kanalizime” sha Roskovec (Per ushtrimin e mbyllur ne date 31 Dhjetor 2020)

rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

- Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

- Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

- Kapitali themeltar

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale.

- Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit. Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetëndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në “Ndërtim në

SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

“Ujesjelles Kanalizime” sha Roskovec (Per ushtrimin e mbyllur ne date 31 Dhjetor 2020)

proçes” dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitetit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë. Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundur që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Normat e amortizimit të përdorura janë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Ndertesa	Vlera e mbetur	5%
Linjat	Vlera e mbetur	5%
Makineri e pajisje	Vlera e mbetur	20%
Mjete transporti	Vlera e mbetur	20 %
Paj, informat	Vlera e mbetur	25%
Pajisje zyre	Vlera e mbetur	20%

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundur që njësi ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

“Ujesjelles Kanalizime” sha Roskovec (Per ushtrimin e mbyllur ne date 31 Dhjetor 2020)

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme.

Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2020 është 15% (2019: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat priten të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivitetet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundur që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

“Ujesjelles Kanalizime” sha Roskovec (Per ushtrimin e mbyllur ne date 31 Dhjetor 2020)

Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

Aktivitet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumëve të humbjes.

Postet e bilancit paraqiten:

Aktive monetare per 2.592.789 leke, paraqesin mjete monetare ne banke.

Shoqëria operon me Raiffeisen Bank dhe Credins banke, te gjitha veprimet jane rregjistruar ne ditaret perkates, gjendja e tyre perputhet me postat e bankes.

Te drejta te arketueshme në vlerën 36.613.753 lekë detajohen si më poshtë:

Nga aktiviteti i shfrytezimit ne shumen 33.964.913 leke paraqet llogarine Kliente per vleren e faturave te paarketuara, kjo llogari eshte e analizuar sipas klienteve dhe rakordon me llogarine sintetike.

Te tjera kerkesa ne shmen 48.840 leke paraqet punonjes debitor.

SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

“Ujesjelles Kanalizime” sha Roskovec (Per ushtrimin e mbyllur ne date 31 Dhjetor 2020)

Kapital i nenshkruar i papaguar ne shumen 2.600.000 leke paraqet kapitalin e nenshkruar te paderdhur nga aksioneri.

Llogarite inventariale paraqesin **“Lende te para e materiale te konsumueshme”** per 2.765.166 leke e inventar te imet ne shumen 60.877 leke.

Aktive afatgjata materiale

Shoqeria ka nje vlere neto aktivesh afatgjata materjale per 557.458.833 leke, aam jane shtuar gjate vitit 2020 ne shumen 135.783 leke ne zerin makineri e pajisje. Aktivet afatgjata materiale jane pakesuar per amortizimin e llogaritur ne shumen 34.317.314 leke dhe eshte kontabilizuar per te njejten shifer ne shpenzime, shuma e llogaritur eshte sipas ligjit per tatimin mbi te ardhurat.

DETYRIMET DHE KAPITALI

Kapitalet e veta paraqiten me vlerë -126.901.654 lekë.

Kapitali i nënshkruar i shoqërisë është 3.500.000 lekë, ai perputhet me ekstraktin historik te shoqerise te nxjerre nga QKB.

Humbje te mbartur ne shumen 89.647.056 leke.

Humbje e ushtrimit sipas bilancit kontabël paraqitet per 40.754.598 leke.

Detyrimet

Detyrimet me vlerë 726.393.072 lekë përfaqësojnë:

	<u>Viti 2020</u>	<u>Viti 2019</u>
Detyrime ndaj institucionit te kredise		
Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit	41.912.702	28.567.535
Te pagueshme ndaj punonjesve dhe sigurimeve shoqerore	2.125.656	4.213.849
Detyrime tatimore	3.493.098	2.019.213
Te tjera detyrime		15.300
Grante dhe mardhenie me bashkine	678.861.616	680.353.705
Totali	726.393.072	715.169.602

Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit per 41.912.702 leke paraqesin llogarine furnitore per vlerën e faturave të palikujduara, kjo llogari është e analizuar sipas furnitoreve dhe rakordon me llogarinë sintetike të tyre.

Te pagueshme ndaj punonjesve dhe sigurimeve shoqerore paraqitet detyrimi i shoqerise per pagat e punonjesve ne shumen 1.540.104 leke dhe sigurimet shoqerore ne shumen 585.552 leke.

Detyrimet tatimore paraqesin:

- **Tatim page** per 67.974 leke.

SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

“Ujesjelles Kanalizime” sha Roskovec (Per ushtrimin e mbyllur ne date 31 Dhjetor 2020)

- *Tatim ne burim* per 10.704 leke,
- *Tvsh* 3.414.419 leke.

Fond k/parti aset.te ardh nga Ujesjellesi Fieri dhe Bashkia Roskovec ne shumen 655.322.831 leke.

Mardhenie me Ujesjellesin Fier dh Bashkine Roskovec ne shumen 23.538.785 leke paraqet debitorët e transferuar.

Verifikimi i llogarise Fitime Humbje

Shpenzimet dhe të ardhurat janë grupuar si më poshtë:

	<i>Viti 2020</i>	<i>Viti 2019</i>
Te ardhura		
Nga shitja e mallrave	30.036.901	24.860.295
Te ardhura te tjera te shfrytezimit	445.541	1.194.925
Totali (Afarizmi)	30.482.442	26.055.220
Materiale te konsumuara	1.286.859	1.529.865
Energji elektrike	9.478.965	9.562.918
Kosto e punes	24.587.935	26.827860
Pagat e personelit	21.069.353	22.988.740
Shpenzime te tjera per personelin		
Shpenzimet per sigurime	3.518.582	3.839.120
Amortizimi dhe zhvleresimet	34.317.314	30.001.850
Shpenzime te tjera	3.525.475	2.853.677
Totali i shpenzimeve	73.196.548	70.776.170
Te ardhurat nga subvencionet	1.109.250	3.881.861
Ter ardhura nga kamatat	559.088	629.146
Te ardhura te tjera	291.170	1.095.558
Humbje ushtrimit	(40.754.598)	(39.114.385)

Shpenzimet jane 73.196.548 leke, ndersa te ardhurat 32.441.950 lekë. Rezultati neto që shoqëria ka realizuar nga veprimtaria e saj gjate ketij viti ushtrimor është humbje ne shumen 40.754.598 leke.

Te ardhurat perfaqesojne te ardhura nga shitja e ujit dhe largimi i ujrave te ndotura per 30.036.901 leke, te ardhura nga kontratat ne shumen 429.500 leke, sahatet 16.041 leke dhe te ardhura nga kamatat ne shumen 559.088 leke dhe te tjera ne shumen 291.170 leke. Gjithashtu ne te ardhura jane perfshire edhe subvencionet e dhena nga buxheti per likujdim fatura energjie elektrike dhe detyrime tatimore ne shumen 1.109.250 leke. Shitjet jane rregjistruar korrekt ne librat e shitjeve dhe te ardhurat rakordojne me situaten tatimore.

Shpenzimet per 73.196.548 lekë, jane te justifikuara me dokumenta te rregullta fiskale. Më konkretisht shpenzimet sipas zërave paraqiten:

Shpenzime per materiale ne shumen 1.286.859 lekë, ato janë përdorur për veprimtarinë kryesore të shoqërisë, këto shpenzime janë të justifikuara me dokumenta. Shpenzime per energji elektrike ne shumen 9.478.965 leke.

SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

“Ujesjelles Kanalizime” sha Roskovec (Per ushtrimin e mbyllur ne date 31 Dhjetor 2020)

Personeli, në këtë llogari janë pasqyruar shpenzimet për paga 21.069.353 lekë, dhe sigurime shoqërore 3.518.582 leke, shpenzimet për paga e sigurime janë vendosur korrekt në këtë llogari.

Shpenzime amortizimi ne vleren 34.317.314 leke nuk i kalon kufijte e fiskut.

Shpenzime te tjera per 3.525.475 leke paraqesin:

- shpenzime per qera 135.000 leke,
- komisione banke 9.500 leke,
- auditueset plus keshilli mbikqyres 1.096.320 leke,
- shpenzime mirembajtje dhe riparime 160.000 leke,
- mirembajtje sistemi faturave 84.000 leke,
- shpenzime siguracioni 28.156 leke,
- taksa mjetesh 18.097 leke,
- shperblim punonjesish 134.181 leke
- shpenzime gjoba 1.860.221 leke,

Rezultati ushtrimor neto që shoqëria ka realizuar nga veprimtaria e saj është humbje ne shumen 40.754.598 leke leke.

Administrator

Isa Hoxha

